



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2023

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8577,
DATË 10.2.2000, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 17 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Paga mujore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.96 me pagën e Presidentit të Republikës. Paga mujore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit, në çdo rast, nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Përveç pagës mujore, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese përfiton një shtesë për shkak të natyrës së veçantë të punës, në masën 58% për qind të pagës.”.

3. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, për pozicionin drejtues përfiton edhe 20% shtesë page mbi pagën mujore të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe shtesës për shkak të natyrës së veçantë të punës.”.

Neni 2

Dispozitë transitorë

1. Paga mujore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese indeksohet për herë të parë nga Këshilli i Ministrave jo më herët se data 1.1.2026.
2. Përveç pagës mujore, sipas pikës 1, të nenit 1, të këtij ligji, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, deri në perfundimin e mandatit të tyre, përfitojnë edhe:
 - a) pagesë mujore shtesë për shkak të vështirësisë, sipas pikës 4, të nenit 29, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në masën 43% mbi pagën mujore;
 - b) shtesë për vjetërsi sipas shkronjës “c”, të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Kryetari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për pozicionin drejtues përfiton edhe 20% shtesë page mbi pagën mujore të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, shtesës për shkak të vështirësisë dhe shtesës për vjetërsi.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr._____, datë_____

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA
DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8577, DATË 10.2.2000,
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS
KUSHTETUESE”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”, për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

MINISTRI I DREJTËSISË

ULSI MANJA